



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jednitica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No	05-3085
Nr. i faqeve Br.stranica No. pages	-06-
Data: Datum: Date: 31.05.2020	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Ured Generalnog Sekretara / Office of the Secretary General

Prishtinë, 31/05/2020

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, ne zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetësinë publik, duke respektuar konkluzionet e takimit të dt.29/05/2020 të Komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me Koronavirus, Ministria e Shëndetësisë, nxjerr;

Qarkore Informative Nr. 11/2020 për informimin e Institucionet Shëndetësore publike dhe private

Për Të gjitha Institucionet Shëndetësore publike dhe private

Qëllimi: i kësaj Qarkoreje është zbatimi i Planit për rikthim në normalitet të shërbimeve shëndetësore;

Obligohen:

1. Të gjitha Institucionet shëndetësore publike dhe private varësisht prej kapaciteteve të fillojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
2. Të gjitha Institucionet shëndetësore publike dhe private të sigurojnë kushtet dhe masat mbrojtëse për zbatimin e rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHPK-së;

SHTOJCË: Pjesë e kësaj Qarkoreje është Plani për rikthim në normalitet të shërbimeve shëndetësore;

Shfuqizohet: Qarkorja Informative me numër protokollit 05-1419 e dt 16.03.2020 me të cilin janë informuar ISh publike dhe private për ndërprerjen e operacioneve elektive me përjashtim të rasteve urgjente;

Qarkorja i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Bordit drejtues të SHSKUK-së;
- SHSKUK-së;
- Të gjitha institucioneve shëndetësore publike dhe private;


Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



- IKSHPK;
- QOE;
- Divizionit KPSH;
- Divizionit për licencim dhe akreditim të ISHP-ve;
- Inspektoratit shëndetësor;
- Departamenti Ligjor;
- Arkivit të MSh.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

**Plani i veprimit për rikthim gradual të shërbimeve shëndetësore
në sektorin e shëndetësisë**

Bazuar në situatën epidemiologjike në vend për shkak të situatës së krijuar me COVID-19, e cila ka sjellë deri te nevoja për ndërprerjen e përkohshme të ofrimit të shërbimeve shëndetësore elektive në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë, Ministria e shëndetësisë ka lëshuar Qarkore për informim të institucioneve shëndetësore publike dhe private të Republikës së Kosovës Nr.05/2020 me Nr Prot.05-1419 dt 16.03.2020, në të cilën kërkohej që të ndërprehen operacionet elektive në të gjitha nivelet e Institucioneve shëndetësore publike dhe private në Republikën e Kosovës.

Instituti kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka konstatuar situatë epidemiologjike të qëndrueshme në Republikën e Kosovës me COVID-19, sipas të dhënave deri më 19 maj 2020:

Në Kosovë që nga 08 shkurti e deri me 30 maj 2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 14.855 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe prej tyre pozitive rezultojnë gjithsej 1.070 raste, me gjithsej 30 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më 30 maj është gjithsej 841 raste.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka publikuar ne web faqen, Udhëzuesin e përkohshëm për Aplikimin e Masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në Institucionet shëndetësore publike e private si udhërrëfyes për kalimin prej masave restriktive në ato më fleksibile dhe kthimin gradual në normalitet dhe bashkëjetesën me virusin (SARS-CoV-2)".